



Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për nëntëmujorin e vitit 2005

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për nëntëmujorin e vitit 2005 rezultoi me një tepriçë prej 44.7 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për të përballuar nivelin e deficitit korent dhe kanë çuar në rritjen e rezervës së autoritetit monetar.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit tregtar dhe i atij korent.
- Rritje e konsiderueshme e dërgesave nga emigrantët.
- Rënie e flukseve hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte kundrejt një viti më parë.
- Zvogëlim i dukshëm i pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, i ardhur kryesisht nga tërheqjet e mjeteve tona financiare në formën e investimeve të portofolit dhe depozitave tona jashtë.
- Rritje të mjeteve të rezervës së autoritetit monetar.

I. Llogaria korente

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë nëntëmujorit të vitit 2005, vlerësohen në rreth 4.5 miliardë euro ose rreth 22 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe në shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë, me rreth 73 për qind.

Mëse 93.6 për qind e shpenzimeve korente, gjatë kësaj periudhe, kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 43 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që eksportet e mallrave dhe shërbimeve siguruan përkatësisht rreth 33 për qind dhe 51 për qind të të ardhurave.

Megjithë rritjen prej rreth 22 për qind, të ardhurat faktoriale neto nuk kanë mundur të zbusin deficitin e lartë tregtar në mallra dhe shërbime. Si rezultat, llogaria korente u mbyll me një deficit prej 222.5 milionë eurosh, me rritje vjetore prej rreth 41.5 për qind.

I. 1. Tregtia e jashtme.

Aktiviteti tregtar i Shqipërisë gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2005 shënoi një vlerë prej 1.8 miliardë euro, duke përfaqësuar 40 për qind të vëllimit të transaksioneve korente të kryera gjatë kësaj periudhe. Ekonomia shqiptare dhe tregu i brendshëm mbeten të orientuar drejt importit, i cili vlerësohet të jetë 3.6 herë më i lartë se eksporti.

Kërkesa e brendshme vazhdon të nxisë rritjen e importeve, ndërkohë që ecuria pozitive e eksporteve nuk ka mjaftuar për të ngushtuar deficitin tregtar. Shpenzimet për importe shënuan afërsisht 1.4 miliardë euro, 14.1 për qind më të larta krahasuar me vitin 2004.

Kërkesa për importe u shtua duke i dhënë shtysë importeve nëpërmjet vlerësimit të monedhës vendase (kursi nominal i këmbimit u vlerësua mesatarisht me 3 për qind, gjatë periudhës janar–qershor) dhe një rritje e shpenzimeve për investime. Rritja e konsiderueshme e kreditimit privat gjithashtu, dha kontributin e saj në importin e mallrave. Në terma volumi importet, janë rritur me 2.7 për qind krahasuar me një vit më parë. Importet e artikujve të përpunuar (që përfaqësojnë rreth 30 për qind të totalit të importeve) janë rritur si pasojë dhe e rritjes të çmimeve. Importet e artikujve ushqimorë (që përfaqësojnë 14 për qind të totalit të importeve) janë rritur në terma volumi me 2 për qind duke reflektuar dhe një rënie të çmimeve.

Duke u bazuar në strukturimin e importeve sipas kategorive ekonomike, theksojmë se vazhdojnë të ruhen nivele të larta të mallrave të ndërmjetëm, që përfaqësojnë 46 për qind të totalit të importeve, tregues ky i zhvillimit të mëtejshëm të industrisë së përpunimit aktiv në vend. Ndërkohë që mbetet e lartë gjithashtu kërkesa për mallra kapitale, me një ritëm rritjeje prej 26 për qind. Kërkesa e brendshme për mallra konsumi ka bërë që edhe gjatë këtij nëntëmuori kjo kategori të ruajë peshë të konsiderueshme ndaj totalit, rreth 31 për qind.

Ndërkohë, ritmi i rritjes së eksporteve konsiderohet më i ulët (10.5 për qind në euro) krahasuar me 23.6 për qind të një viti më parë. Eksportet në terma volumi u ulën me 1 për qind krahasuar me një vit më parë. Eksportet e artikujve të përpunuar (që përfaqësojnë pjesën më të madhe të eksporteve tona, rreth 70 për qind të totalit) patën një rënie të lehtë (vetëm 0.4 për qind) ndërkohë që çmimet janë rritur. Eksportet e metaleve (që përfaqësojnë 12 për qind të totalit të eksporteve) kanë pësuar rënie në volum me 6 për qind edhe pse çmimet janë

rritur gjatë kësaj periudhe. Volumi total i eksporteve gjatë vitit 2005 është vlerësuar 3 për qind më i ulët se ai në vitin 2004.

Industria e përpunimit aktiv rezulton me një suficit prej 56 milionë eurosh, e ardhur kjo nga trendi pozitiv i eksporteve me material porositësi, të cilat vazhdojnë të jenë dominuese duke zënë 70 për qind të vëllimit të përgjithshëm të eksporteve. Në të njëjtën kohë, theksojmë se verehen tendenca pozitive drejt eksportit të brendshëm.

Kështu nëntëmujori i vitit 2005 regjistroi një deficit tregtar prej 1 miliard eurosh, vlerë kjo 14.7 për qind më e lartë se periudha korresponduese e një viti më parë. Deficiti i lartë dhe rregullisht në rritje i tregtisë së jashtme tërheq vëmendjen drejt politikave që synojnë zëvendësimin e importeve dhe nxitjen e eksporteve.

Duke u bazuar në strukturimin e tregtisë së jashtme sipas partnerëve tregtarë, Shqipëria vazhdon të kryejë pjesën më të madhe të transaksioneve të saj me Bashkimin Evropian, por gjithashtu vlen të thuhet se po anohet drejt tregtisë (sidomos në kahun e eksporteve) me vendet e rajonit, e nxitur kjo dhe nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet fqinje.

I. 2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korente.

Tregtia në shërbime dhe investimet në to edhe gjatë kësaj periudhe, si një tregues i rëndësishëm i konkurrencës në tregjet ndërkombëtare dhe i rritjes ekonomike, po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një element të rëndësishëm të integritimit me jashtë për Shqipërinë. Transaksionet tregtare në shërbime arritën në 1.4 miliardë euro dhe vlerësohen 26 për qind më të larta, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2004. Llogaria e shërbimeve u mbyll me një bilanc negativ prej 97 milionë eurosh. Ky deficit ka ardhur kryesisht si pasojë e një bilanci negativ të kategorisë së shërbimeve të transportit. Ashtu siç pritej rritja e vëllimit të importit të mallrave ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të transportit.

Një rritje të konsiderueshme kanë pësuar edhe shërbimet e tjera të biznesit dhe ato kulturore. Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet në shërbime për "turizëm" (udhëtime), të cilat kontribuojnë në masë të konsiderueshme flukset hyrëse dhe dalëse të kësaj kategorie, përkatësisht me 74 dhe 60 për qind të totalit për këtë nëntëmujor. Aktualisht, aktiviteti i turizmit vazhdon të përfaqësojë një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare dhe si i tillë, duhet të konsiderohet si një nga motorët e rritjes ekonomike të vendit. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, gjatë nëntëmujorit të vitit 2005, eksporti në turizëm, ka gjeneruar rreth 516 milionë euro flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 30 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave dhe vlerësohet të jetë 17 për qind më i lartë kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2004. Kjo rritje, ka ardhur kryesisht nga rritja e fluksit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin si dhe nga rritja e lehtë e koeficientëve vlerësues të shpenzimeve ditore. Gjatë këtij nëntëmujori, numri i

shtetasve të huaj në Shqipëri është rritur me 21 për qind, ku pesha kryesore e kësaj rritjeje bie mbi muajt korrik- shtator, duke shfaqur edhe faktorin sezonal të pushimeve verore.

Aktivitet i përshpejtuar vërehet në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Kështu, rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 478 milionë euro ose sa 67.4 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët.

Ekonomia shqiptare përfiton të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, dhe njëkohësisht paguan interesat për borxhin e jashtëm.

Bilanci pozitiv i të ardhurave në fund të vitit vlerësohet rreth 106 milionë euro. Ky suficit i dedikohet të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë e atyre kufitare dhe interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente si dhe atyre të përfuara nga investimet e sistemit tonë bankar në formën e investimeve të portofolit.

Bilanci i transfertave korente, në fund të nëntëmujorit, u vlerësua në rreth 791 milionë euro ose 8.6 për qind më i lartë se ai i të njëjtës periudhë kohore të vitit 2004. Peshën kryesore (rreth 77 për qind) të të ardhurave në këtë kategori, vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transferta kanë arritur nivelin 709.4 milionë euro, duke qenë 21 për qind më të larta se ato të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Këto transferta përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit tregtar (në mallra dhe shërbime) në mëse 63.3 për qind të tij. Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transferta shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (33 milionë euro), të cilat vlerësohen me një rritje prej 5 për qind kundrejt periudhës paraardhëse.

II. Llogaria kapitale dhe financiare

Flukset neto të kapitalit, gjatë këtij nëntëmujori, regjistruan 248 milionë euro, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent, si dhe kontribuan në rritje të rezervave valutore. Pas kësaj shifre pozitive qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 75 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 173 milionë eurosh. Krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit 2004, pozicioni neto i llogarisë kapitale dhe financiare vlerësohet rreth 26 milionë euro më i ulët. Kujtojmë se gjatë gjysmës së parë të vitit 2004 janë regjistruar flukse të larta kapitali për efekt të privatizimit.

Transfertat kapitale gjatë kësaj periudhe, u ulën me rreth 2.6 milionë euro ndërkohë që, bilanci pozitiv i llogarisë financiare vlerësohet në rënie ndaj një viti më parë (me rreth 23 milionë euro). Pozicioni i llogarisë financiare këtë tremujor përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 211 milionë euro) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 38 milionë euro). Megjithatë, krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i

detyrimeve financiare vlerësohet më i ulët, rreth 138 milionë euro dhe pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës qëndrojnë, gjithashtu, në një nivel më të ulët (115 milionë euro).

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës, këtë nëntëmujor, ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte (149 milionë euro) dhe huamarrjes me jashtë (me 107 milionë euro). Investimet e huaja direkte vlerësohen të jenë 85 milionë euro më të ulëta kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2004, periudhë në të cilën mëse 60 për qind e fluksit të investimeve të huaja direkte ka hyrë në formën e privatizimit.

Lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës, këtë nëntëmujor kanë qenë 17 milionë euro më të ulëta: huamarrja shtetërore ka rënë lehtë me rreth 3 milionë euro ndërkohë që, ndryshe nga viti i kaluar, përgjatë të cilit është vënë re prania e sektorit privat në huamarrjen afatgjatë, këtë nëntëmujor disbursimet e huave të këtij sektori kanë qenë rreth 14 milionë euro më të ulëta. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 25.5 milionë euro, të barazvlefshme me 10 për qind të eksportit të mallrave.

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të periudhës, regjistroi 123 milionë euro, me një fluks nëntëmujor në rritje prej 7 milionë eurosh. Në përbërjen e tyre strukturore sipas monedhave, 72 për qind i përkasin atyre në dollarë amerikanë, 24 për qind në euro. Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, këtë nëntëmujor janë rritur me rreth 9 milionë euro. Në përbërjen e tyre, depozitat në dollarë amerikanë zënë 53 për qind të tyre, ndërsa 42 për qind janë në euro.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 45 milionë euro. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliard e 72 milionë euro, i mjaftueshëm për të përballuar 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Bilanci i Pagesave
në milionë EURO

	Q3 2004	Q4 2004	Q1 2005	Q2 2005	Q3 2005
Llogaria korente	-25.5	-129.0	-51.6	-103.9	-67.0
Eksporti i mallrave	121.6	125.0	121.5	143.3	133.7
Importi i mallrave	-450.9	-514.4	-398.0	-507.0	-515.9
Bilanci tregtar	-329.3	-389.4	-276.5	-363.7	-382.2
Shërbimet: Kredi	223.8	201.1	196.5	237.4	262.0
Shërbimet: Debi	-229.0	-230.4	-225.9	-261.0	-306.2
Të Ardhurat: Kredi	55.8	39.3	37.4	39.5	51.2
Të Ardhurat: Debi	-5.1	-6.8	-5.1	-9.6	-7.6
Transferta private pashpërblim	244.5	242.3	210.2	243.3	295.0
Transferta shtetërore pashpërblim	16.7	18.5	11.8	10.1	20.8
Llogaria kapitale	29.1	28.5	35.5	14.6	25.0
Llogaria financiare	-15.2	110.7	24.4	134.4	4.6
Investime direkte	58.7	42.6	45.3	50.3	53.0
Investime portofoli	98.2	-95.9	-42.9	-5.3	40.9
Kapitale të tjera*	-172.2	164.0	21.9	89.4	-89.3
Gabime dhe harresa neto	84.9	35.6	-3.3	-43.7	66.2
Bilanci i përgjithshëm	78.1	45.9	9.7	1.4	33.7
Rezervat dhe zëra të lidhur me to					
Mjetet e rezervës	-78.1	-45.9	-9.7	-1.4	-33.7
Përdorim huash e kredish nga FMN	4.8	0.0	4.6	0.0	4.8
Për t'u mbajtur në vëmendje					
Ndryshimi total në rezerva	-84.4	-95.2	15.7	35.3	-30.1
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	6.3	49.3	-25.4	-36.7	-3.6

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN